

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Podujeva – Raporti komunal

Nëntor 2009

Podujeva në shifra

Popullsia	Gjithsej	109601	
	Shqiptarë	98%	
	Serbë	1%	
	Të tjerë	1%	
Gjeografia	Sipërfaqja (km ²)	633	
	Numri i fshatrave	76	
Shkollimi	Pa shkollë/fillore e papërfunduar	16.99%	
	Filllore/e mesme e papërfunduar	39.06%	
	E mesme	36.44%	
	Shkollë e lartë	6.33%	
	Universitet	1.18%	
	Nr. i nxënësve	23574	
	Nr. i mësimdhënësve	1224	
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	4	
	Nr. i shkollave fillore (me paralele të ndara)	63	
	Nr. i çerdheve	1	
	Shëndetësia	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare	1
		Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore	21
Nr. i mjekëve		54	
Papunësia	Gjithsej	55.17%	
	Meshkuj	48.37%	
	Femra	73.23%	
Të punësuar	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	66,857	
	Të punësuar në sektorin publik komunal	1,892	
Buxheti 2009	Gjithsej (Euro)	11,151,357	
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	981,000	
	Të hyrat tjera (Euro)	10,170,357	
Shpenzimet e realizuara (2008)¹	Gjithsej (Euro)	8,494,471 (96%)	
	Shpenzimet kapitale (Euro)	2,131,245 (89%)	
	Shpenzimet tjera (Euro)	6,363,226 (98.7%)	
Rezultatet e zgjedhjeve lokale 2007	LDK	48.53%	
	PDK	33.32%	
	AKR	7.65%	
	AAK	4.64%	
	PD	2.47%	
	ORA	1.18%	
	Tjera	2.20%	
Kryetarët e Komunës 2000-2009	2000-2002: Agim Veliu (LDK) 2002-2007: Agim Veliu (LDK), Agim Kikaj (LDK) 2007-2009: Ilaz Pireva (LDK)		

¹ Në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion.

Shkurt për Podujevën

Podujeva, jo zyrtarisht e quajtur edhe Besiana, shtrihet në pjesën verilindore të Kosovës dhe ka një sipërfaqe prej 633 km². Qyteti së bashku me 76 fshatrat ka një popullatë prej 109,601 banorë, ku 98% janë shqiptar, kurse 1% serb dhe 1% romë. Ky rajon njihet edhe si “rajoni i Llapit”, për shkak se shtrihet në fushëgropën e Llapit dhe, për pjesën tjetër të Kosovës, banorët e kësaj komune njihen edhe si “llapjanë”. Në territorin e kësaj komune ndodhet liqeni më i madh në Kosovë – Liqeni i Batllavës, nga i cili furnizohen me ujë (pjesërisht) katër komuna: Podujeva, Prishtina, Obiliqi dhe Fushë Kosova. Liqeni i Batllavës tërheq shumë vizitor nga pjesët tjera të Kosovës, sidomos gjatë sezonit veror, për shkak se ambienti përreth ofron kushte të mira për pushim dhe shëtitje në natyrë. Përkaj qytetit të Podujevës kalon një nga rrugët më të rëndësishme, e cila lidh Kosovën me pjesët tjera të Ballkanit. Rëndësia e kësaj rruge, por edhe perspektiva për zhvillim ekonomik të komunës, pritet të rritet pas ndërtimit të autostradës Morinë-Merdare.

Problemet aktuale

Qytetarët e komunës së Podujevës përballen me probleme të shumta jetike, siç janë papunësia, varfëria, zhvillimi i ulët ekonomik, mungesa e ujit të pijes, etj. Nga numri i përgjithshëm i popullsisë prej 109,601 banorëve, 66,857 apo 61% e tyre janë të aftë për punë (15-64 vjeçar). Por, papunësia arrin shkallën prej 55% dhe Podujeva radhitet si e shtata për nga numri i papunësisë në krahasim me komunat tjera. Në Qendrën Komunale për Punësim janë të regjistruar 10,548 punëkërkuar, e që është 15.7% e popullsisë së aftë për punë. Mirëpo, papunësia e regjistruar nuk paraqet gjendjen reale të papunësisë, pasi që shumë punëkërkuar nuk kërkojnë punë përmes Qendrës Komunale për Punësim. 1157 familje me 5560 anëtarë (5% e popullsisë) marrin asistencë sociale. Qytetarët janë të zhgënjyer me procesin e privatizimit në këtë komunë, pasi që përkundër pritjeve, nuk ka ndikuar që të rritet numri i të punësuarve në ndërmarrjet dikur publike, siç janë: Tjegullorja, Fabrika e Armaturës Ndërtimore, kombinati i drurit, etj. Përveç këtyre problemeve bazike, ankesat e qytetarëve kanë të bëjnë edhe me:

- Papastërtia e ambientit, sidomos e lumit Llap;
- Rreziku në komunikacion, mungesa e nënkalimeve dhe mbikalimeve;
- Posedimi i armëve pa leje;
- Infrastruktura jo e mirë shkollore;
- Prerja e pyjeve;

Një ndër problemet e qytetarëve të Komunës së Podujevës është edhe **papastërtia e Lumit Llap**, sidomos pjesa afër stacionit të autobusëve (“Kosovatransi”) në qendër të qytetit, ku edhe derdhen vajrat motorike. Përveç në këtë pjesë, shtrati i lumit është i ndotur në tërësi, sidomos në pjesët jashtë qytetit të Podujevës ku hidhen mbeturinat dhe ujërat e zeza. Komuna ka bërë pastrimin e një pjesë të lumit në qendër të qytetit, por edhe më tutje shtrati i lumit Llap mbetet shumë i ndotur. Përveç lumit, edhe ambienti në përgjithësi është i ndotur, sidomos me deponi ilegale të mbeturinave. Edhe në pjesët për grumbullimin e mbeturinave, në ato vende të pakta ku ekzistojnë kontejnerët dhe ka qasje kompania për grumbullimin e tyre, mbeturinat nuk largohen shpesh, çfarë bën që edhe deponitë legale të stërngarkohen.

Mungesa e nënkalimeve dhe mbikalimeve rrugore. Komuna e Podujevës është qytet nëpër të cilin kalon rruga kryesore që lidh Kosovën me pjesët e tjera të Ballkanit. Në mungesë të sinjalizimeve të duhura dhe për faktin se shumë vozitës që përshkojnë këtë rrugë nuk e njohin terrenin, ndodhin aksidente të shpeshta në komunikacion. Për çdo vit në këtë komunë humbin jetën 2-3 qytetarë (kryesisht nxënës, të cilët udhëtojnë për në shkollë). Vetëm në 2009 katër nxënës kanë humbur jetën. Qytetarët shprehen se ndërtimi i mbikalimeve, nënkalimeve, apo prezenca më e madhe e policisë në këtë pjesë të rrugës, do të bënte që ata të ndihen më të sigurt kur përcjellin fëmijët e tyre për në shkollë.

Përdorimi i armëve pa leje. Mbjajtja e armëve për banorët e kësaj ane është traditë që ka ekzistuar që moti. Por mbajtja e armëve, kryesisht pa leje pasi që ligjet në Kosovë nuk mbështesin mbajtjen e armëve, ka ndikuar në shfaqjen e problemeve të shumta. Në këtë komunë edhe më tutje është prezent fenomeni i hakmarrjes. Gjithashtu, tradita e shtirjes me armë gjatë manifestimeve gazmore, siç janë dasmat, është më e theksuar në këtë rajon. Si pasojë e përdorimit të shpeshtë të armëve, ndodhin vrasje të qëllimshme dhe aksidentale. Sipas statistikave të Policisë së Kosovës, gjatë vitit 2008 në këtë komunë kanë ndodhur 15 vrasje. Për nga numri i vrasjeve Podujeva radhitet e gjashta në krahasim me komunat e tjera. Të vetëdijshëm për këtë fenomen, komuna dhe policia kanë marrë masa në parandalimin e të shtënave në ahengje. Komuna ka organizuar debat me temën “Parandalimi i të shtënave me armë zjarri nëpër ahengje”, debat i cili është karakterizuar me pjesëmarrje të madhe të qytetarëve. Mirëpo qytetarët e kësaj komune kërkojnë angazhim më të madh të komunës dhe të policisë së Kosovës në vetëdijesimin e qytetarëve për pasojat e përdorimit të armëve, si dhe konfiskimi i këtyre armëve.

Objekti i vjetruar i shkollës fillore në Batllavë. Në fshatin Batllavë të Podujevës, objekti i shkollës fillore “Luigj Gurakuqi” është ndërtuar që në vitet e ‘60. Në këtë shkollë zhvillojnë mësimet rreth 400 nxënës. Shumicës prej nxënësve u duhet të ecin gjatë deri tek objekti i shkollës. Përveç rrugës së gjatë që duhet të përshkojnë nxënësit, problem më madhor paraqet gjendja jo e mirë e objektit ku zhvillohet mësimi. Nuk ka hapësirë të mjaftueshme për të gjithë nxënësit. Tani së fundmi, salla e arsimitarëve është shndërruar në klasë mësimi. Objekti nuk është i sigurt për mbajtjen e mësimi. Prindërit dhe mësimdhënësit i frikohen ndonjë shembje të mundshme të objektit.

Prerja e pyjeve. Pjesa më e madhe e territorit të kësaj komune është terren malor. Pyjet janë një nga pasuritë e kësaj komune dhe shumë qytetarë sigurojnë nxehjen nga drunjtë. Agjencioni Pyjor i Kosovës lëshon lejet për prerjen e pyjeve. Mirëpo problem i madh në këtë komunë është edhe prerja ilegale e drunjëve. Podujeva është një nga pesë komunat e me raste më të shpeshta të keqpërdorimit të pyjeve. Sipas Ligjit për pyje, menaxhimi i pyjeve është nën kompetencë të Agjencionit Pyjor të Kosovës, por me ndryshimet që parashihen ti bëhen këtij ligji dhe me bartjen e kompetencave tek komunat, këto kompetenca do ti kalojnë pushtetit lokal. Mbetet të shihet nëse këto ndryshime të kompetencave do të sjellin edhe ndryshime në menaxhim më të mirë me pyjet.

Premtimet dhe puna e Kryetarit të Komunës

Në tri palë zgjedhjet e gjertanishme, me komunën e Podujevës ka udhëhequr LDK, përmes tre kryetarëve të ndryshëm. Në mandatin e parë qeverisës (2000-2002) kryetar komune ishte Agim Veliu. Agim Veliu udhëhoqi me komunën edhe në vitet 2002-2004, kur la postin e kryetarit të Komunës për postin e ministrit të Ministrisë së Arsimit. Pas dorëheqjes së Agim Veliut, drejtimi i komunës iu besua Agim Kikajt. Në zgjedhjet e para të drejtpërdrejta për kryetar komune më 2007, fitues doli Ilaz Pireva nga LDK. Në raundin e parë të zgjedhjeve, Ilaz Pireva fitoi 15,008 vota apo 49.1%; kurse tri javë më vonë në zgjedhjet e balotazhit ai fitoi 54.1% të votave.

Gjatë fushatës zgjedhore u premtua zgjidhja e rasteve sociale në komunë, ndërtimi i bibliotekës së qytetit, pastrimi i lumit Llap, asfaltimi i rrugës Podujevë-Orllan, rregullimi i Sheshit të Lirisë, etj. Dy vite më pas, këto projekte janë realizuar pjesërisht. Tabela 1 pasqyron të gjitha premtimet e dhëna në debatet “Jeta në Kosovë” dhe realizimi i tyre dy vite më vonë.

Tab.1. Premtimet dhe realizueshmëria e tyre

Premtimet	Realizimi
Vëmendje më e madhe për raste sociale në komunë	Deri më tani rastet sociale janë trajtuar nga niveli qendror, saktësisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Kjo pritet të ndryshoj pas që me bartjen e kompetencave, menaxhimi me rastet sociale do të kaloj komunave. Gjatë këtyre viteve, numri i familjeve që janë të varura nga ndihmat sociale ka shkuar duke u rritur. Sipas të dhënave të Departamentit të Mirëqenies Sociale të MPMS, në komunën e Podujevës asistencë sociale marrin 1157 familje me 5560 anëtarë (apo 5% e popullsisë).
Ndërtimi i Bibliotekës së Qytetit dhe ngritja e vetëdijes për lexim.	Edhe më tutje qyteti nuk ka Bibliotekë. Ndërtimi i bibliotekës dhe pasurimi i saj me tituj të rinj është besuar se do të rris edhe lexueshmërinë e librit.
Pastrimi i lumit Llap	Lumi Llap kalon në qendër të qytetit të Podujevës. Komuna ka bërë pastrimin e tij në qendër të qytetit, mirëpo në pjesët tjera ky lum mbetet ende i ndotur. Ndotja e lumit Llap dhe ambientit të përgjithshëm përbëjnë një nga shqetësimet më të mëdha të qytetarëve të kësaj komune.
Asfaltimi i rrugës Podujevë-Orllan	Kjo rrugë është asfaltuar.
Rregullimi i Sheshit të Lirisë	Sheshi i Lirisë është rregulluar.

Zgjedhjet lokale në Podujevë

Në Kuvendin Komunal të Podujevës mund të zënë ulëse 41 përfaqësues partiak. Në tri palë zgjedhjet e gjertanishme lokale, 22 subjekte të ndryshme politike kanë garuar

për të siguruar përfaqësim në KK të Podujevës. Shtatë prej tyre kanë arrit që të përfaqësohen, kurse vetëm tri parti politike kanë siguruar përfaqësim të vazhdueshëm në të tri mandatet.

LDK ka arrit që të siguroj numrin më të madh të ulëseve në çdo mandat, edhe pse më një rënie të vogël pas çdo palë zgjedhjesh. Në zgjedhjet e para lokale të 2000, LDK fitoi 28 ulëse, PDK 10 dhe AAK 3. Shtatë subjekte tjera (gjashtë parti dhe një kandidat i pavarur) nuk arritën që të fitojnë ndonjë vend në legjislaturën lokale. LDK doli fituese edhe në zgjedhjet e dyta më 2002, por kësaj radhe siguroi 25 ulëse dhe me afro 4,000 vota më pak. PDK fitoi 4 ulëse dhe afro 1,000 vota më shumë. AAK shënoi rënie, kurse nga 11 subjektet tjera politike që garuan në këto zgjedhje, vetëm PD dhe Balli Kombëtar arritën që të përfaqësohen me nga një këshilltar. Pesë vite më pas, në zgjedhjet lokale të 2007, LDK për herë të tretë radhazi fitoi shumicën e ulëseve në KK, por kësaj radhe pesë ulëse më pak se një mandat më parë. Ndarja e anëtarësisë së LDK në dysh, nuk pati pasoja në përgjysmimin e kësaj partie edhe në vota. PDK sërish shënoi një ngritje dhe fitoi dy ulëse më shumë. AAK pësoi rënie në vota por arriti të mbaj sërish dy ulëse. Këto zgjedhje nxorën AKR-në si subjektin e tretë më të madh.

Tab.2. Partitë të cilat kanë arritur që të fitojnë ulëse në KK të Podujevës.

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	7779	10	8685	12	9786	14
LDK	22193	28	18723	25	14256	20
AAK	2823	3	1688	2	1362	2
PD	-	-	499	1	725	1
AKR	-	-	-	-	2248	3
ORA	-	-	-	-	348	1
Balli Kombëtar	-	-	461	1	-	-

Edhe numri i votuesve ka shkuar duke rënë gjithnjë në tri palë zgjedhjet lokale. Përderisa në zgjedhjet e para lokale dalja e votuesve në zgjedhje ishte 76.3%, dy vjet më vonë ajo ra në 54.1%, kurse në 2007 pjesëmarrja ishte 47%. Sikurse në çdo komunë tjetër, edhe në komunën e Podujevës në tri palë zgjedhjet e kaluar numri i votuesve me të drejtë vote ka shkuar duke u rritur, kurse pjesëmarrja e tyre në votime ka shkuar duke rënë. Në zgjedhjet e ardhshme të 15 Nëntorit 2009 të drejtë vote kanë 72,974 qytetarë.

Tab.3. Statistikat e daljes së votuesve në zgjedhjet lokale në Podujevë në tri palë zgjedhjet e gjertanishme

	2000	2002	2007	2009
Votues me të drejtë vote	46915	60362	62396	72974
Pjesëmarrja në votime	35796	32686	29374	-
Përqindja e daljes në votime	76.3%	54.15%	47%	-

Buxheti i Komunës

Komuna e Podujevës prej vitit 2003 deri në vitin 2008 ka pasur një buxhet mesatarisht prej 9 milion euro. Buxheti i vitit 2009 bënë përjashtim. Nga tabela e më poshtme mund të vërehet se në 2009 Komuna e Podujevës ka buxhetin më të lartë ndonjëherë, gjithsej 12,638,499 euro. Krahasuar me vitin 2008, buxheti i vitit 2009 është më i madh për 2,811,671 euro. Shumica e mjeteve nga ky buxhet janë shpenzuar për rroga dhe mëditje.

Tab.4. Shpenzimet buxhetore sipas viteve dhe sipas linjave buxhetore

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Gjithsej
2009	€7,018,502	€1,037,922	€475,437	€213,121	€3,893,517	€12,638,499
2008	€5,930,600	€1,262,171	€398,325	€213,121	€2,022,611	€9,826,828
2007	€5,684,217	€1,133,275	€456,325	€224,983	€1,018,246	€8,517,046
2006	€5,642,366	€1,117,206	€379,174	€228,998	€2,093,197	€9,460,941
2005	€5,459,317	€993,022	€245,550	€178,000	€2,269,060	€9,144,949
2004	€5,644,251	€1,400,141	-	-	€2,139,108	€9,300,407
2003	€4,368,335	€1,884,391	-	-	€2,799,556	€9,393,532

Buxhetin e vitit 2008 komuna ka arrit ta shpenzoj në masën 96%. Kurse për gjashtë mujorin e parë të 2009, buxheti është shpenzuar në masën 35.4%. Sa i përket arkëtimit të të hyrave vetanake, në vitin 2008 komuna ka arkëtuar 975,000. Mirëpo, edhe përkundër rritjes së të hyrave në krahasim me 2007, komuna nuk ka arrit që të përmbush planifikimet buxhetore, pasi planifikimet buxhetore janë realizuar vetëm 97.4%. Komuna e Podujevës është një ndër të paktat e cila nuk ka mund të realizoj planifikimet për të hyrat buxhetore. Në gjashtë mujorin e parë të 2009, të hyrat janë më të larta për 35% në krahasim me të njëjtën periudhë të 2008.

Investimet kapitale

Nga buxheti i përgjithshëm, Komuna e Podujevës për vitin 2009 ka ndarë 3,893,517 euro për investime kapitale. Për dy vite (2008 dhe 2009), kjo qeveri lokale ka ndarë afër 6 milion euro për këtë qëllim. Në tabelën e mëposhtme mund të shihni disa nga projektet e financuara nga ky buxhet.

Tab.5.: Investimet kapitale në Podujevë gjatë 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Shuma e Projekteve
2008	Asfaltimi i rrugës në fshatin Sibovc	€110,000
2008	Asfaltimi i rrugës në fshatin Lladovc	€108,405
2008	Rindërtimi i rrugës Stubëll-Podujevë	€125,455
2008	Asfaltimi i rrugës Hasan Prishtina	€165,100
2008	Asfaltimi i rrugës Batllavë-Dumosh-Sveqël	€350,000
2008	Asfaltimi i rrugës Sekiraqë	€125,000
2008	Ndërtimi i palestrës sportive	€138,673
2009	Asfaltimi i rrugës në fshatin Llugë	€144,150
2009	Asfaltimi i rrugës Podujevë-Livadicë	€114,600
2009	Asfaltimi i rrugës Batllavë-Gërdovc	€143,250

2009	Asfaltimi i rrugës Letanc-Bajcinë	€241,000
2009	Asfaltimi i rrugës Llapashticë e epërme	€126,060

Kuvendi Komunal i Podujevës ka miratuar edhe Buxhetin e Komunës për vitet 2010-2012. Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, kjo komunë do të ketë në dispozicion 16,958,510 euro për investime kapitale.

Tab.6.: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Podujevës 2010-2012

Buxheti	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në €	12,884,568	13,030,227	13,505,534
Të hyrat vetanake në €	1,280,556	1,321,208	1,359,320
Investimet kapitale në €	5,589,315	5,446,944	5,922,251

Nëse mund të japim një vlerësim të përafërt edhe për vitin 2013, duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012, atëherë mund të përfundojmë se kryetari i ardhshëm i komunës së Podujevës për mandatin e tij qeverisë katërvjeçar do të ketë në dispozicion rreth 22.9 milion euro për investime kapitale.

Administrata komunale

Në komunën e Podujevës të dhënat për vitin 2009 tregojnë se numri i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë është 1,892. Krahasuar me vitin 2008, numri i këtij stafi është rritur për 9 persona. Duke u mbështetur në vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.10/46 (3 dhjetor 2008), e cila thotë se për 750 banorë duhet të ketë një punëtorë administrativ, del se komuna e Podujevës duhet të ketë 211 punëtorë administrativ. Momentalisht, kjo komunë ka të punësuar 233 punonjës në administratën komunale, që do të thotë se sipas këtij raporti komuna duhet të largoj 22 punonjës nga puna.

Tab.7. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Podujevës sipas viteve

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	1892 ▲
2008	1883
2007	1909
2006	1913 ▲
2005	1895 ▲
2004	1889 ▲
2003	1845 ■

Në përgjithësi, mungon rendi dhe rregulli në administratën komunale të Podujevës. Objekti kryesor i komunës nuk është i mirëmbajtur; përkundër ndalesave ligjore, në hapësirën publike pihet duhan; qytetarët ankohen se nuk respektohet orari i punës dhe paraqiten radhë të gjata nëpër sportele.

Komuna e Podujevës dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Sa i përket përmbushjes së obligimeve që dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale, gjegjësisht numrit të mbledhje që duhet t'i mbajtur komunal gjatë një viti, e që duhet të jetë minimum 10 mbledhje në vit, KK e Podujevës në 2008 ka mbajtur 8 mbledhje, që do të thotë se nuk e ka përmbushur normën e paraparë me ligj. Kurse gjatë periudhës janar-qershor 2009, KK ka mbajtur 4 mbledhje të rregullta, numër ky që sipas nenit 43.2 të ligjit të lartpërmendur duhet të ishte 5. Ndërkaq, edhe Komiteti për Politikë dhe Financa nuk është mbledhur rregullisht, ku gjatë vitit 2008 është takuar vetëm 2 herë, kurse në gjashtëmuorin e parë të 2009 ka shënuar një bilanc më të mirë duke u takuar gjithsej 4 herë. Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik të komunës.

Në vitin 2008 Kryetari i Komunës ka mbajtur dy tubime publike me qytetarë, mirëpo të cilët janë shënuar me pjesëmarrje të vogël. Edhe tubimi i mbajtur në pjesën e parë të 2009 nuk kishte arritur që të sjellë mjaft qytetar në tubim.

Komuna e Podujevës ka edhe uebfaqen e saj zyrtare. Në përgjithësi në këtë uebfaqe mund të gjenden informacione të konsiderueshme sa i përket aktiviteteve të komunës. Në shumë fusha mungojnë informacionet, nuk është i publikuar komplet legjislacioni komunal, nuk janë të publikuara procesverbalet e mbledhjeve të KK, nuk ka informacione për aktivitetet e zyrës së prokurorit, investimet kapitale, etj. Edhe pse një uebfaqe e mirëmbajtur jo mirë, në krahasim me komunat tjera uebfaqja zyrtare e kësaj komune radhitet një ndër pesë më të mirëmbajturat.

Tab.8. Niveli i përmbajtjes së informacioneve në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Podujevës (www.podujeva-komuna.org)

Kategoritë e informacioneve	Niveli i informatave ²
Ballina	4
Organizimi komunal	2.67
Shërbimet komunale	3
Info rreth qytetit	4.5
Projektet komunale	2.75
Lajme & lajmërimet	2.67
Harta e faqes	5
Kontakt	5
Gjuhët	5
Fusha për kërkim	5
Tjera informacione shtesë	2
Baza Ligjore	2
Mesatarja totale	3.63
Renditja në krahasim me ueb faqet e komunave tjera	5

² Radhitja nga 1 deri 5: 5 - shkëlqyeshëm, 4-shumë mirë, 3-mirë, 2-mjaftueshëm, dhe 1-dobët.

Gjendja në arsim

Sistemi arsimor zhvillohet në tri nivele; parashkollor, fillor dhe të mesëm. Në Podujevë ekziston një çerdhe fëmijësh, kurse fëmijët parashkollorë mësojnë në 39 paralele parashkollore. Së bashku me paralelet e ndara, ekzistojnë 63 shkolla fillore ku vijojnë mësimin 18,700 nxënës. Janë edhe 4 shkolla të mesme me rreth 4,680 nxënës. Numri i përgjithshëm i punonjësve arsimor është 1,160. Përndryshe kjo komunë ka 1.3 punonjës për 100 banorë, që është përafërsisht e njëjtë me shumicën e komunave të Kosovës.

Maturantët nuk kanë shënuar rezultate të kënaqshme dhe performanca në testin e maturës ka shërbyer edhe si pikë debati në Kuvendin Komunal në mes përfaqësuesve të opozitës dhe Drejtorisë së Arsimit. Edhe rekrutimet e stafit të arsim shërbejnë si arsye për hedhjen e akuzave të ndërsjella mes partive rreth asaj se sa është i politizuar stafi në sistemin arsimor lokal.

Disa nga objektet shkollore janë në gjendje jo të mirë. Më sipër përmendëm rastin e objektit të shkollës fillore në Batllavë, i cili nuk ka hapësirë të mjaftueshme dhe është në rrezik që të shembet.

Gjendja në shëndetësi

Komuna e Podujevës ka QKMF, 14 QMF dhe 7 ambulanca të shpërndara nëpër lokalitete të ndryshme. Nuk ka ndonjë spital, por për rastet më të rënda qytetarët orientohen në QKUK në Prishtinë. Në Podujevë ekziston edhe një numër i madh i ambulancave private. Numri i përgjithshëm i punonjësve shëndetësor është 181, apo 2.3 punëtorë shëndetësor për 1,000 banorë.

Shoqëria civile

Në komunën e Podujevës janë të regjistruara një numër i madh i organizatave joqeveritare, por shumë pak nga to bëjnë monitorimin e punëve të qeverisë komunale. Shumica e OJQ-ve merren me aktivitetet të ndryshme rinore apo gjinore. Prej OJQ-ve të tilla janë: "Alternativa", "Ekovizioni", "Organizata Rinore e Podujevës", "Iniciativa Qytetare e Llapit", "Femrat në Veprim", "Ardhmëria e Llapit", etj. Shumë prej organizatave kanë reduktuar aktivitetet e tyre si shkak i mungesës së përkrahjes financiare.

Mediat lokale

Ekzistojnë dy radio lokale: Radio Vizioni dhe Radio Llapi. Radiot nuk janë shumë të angazhuara në drejtim të monitorimit të punës së organeve komunale dhe informim të qytetarëve rreth aktiviteteve të komunës. Sipas udhëheqësve të radiove, udhëheqësit komunal nuk janë të gatshëm që të bashkëpunojnë me radiot dhe nuk i përgjigjen ftesave për debate. Më herët gazetarët që veprojnë në këtë komunë kanë botuar edhe një revistë javore, revistë e cila tani nuk botohet. Pothuajse të gjitha

mediat e shkruara kanë edhe korrespondentët e tyre në Podujevë, të cilët shkruajnë për aktivitet e komunës dhe ndodhitë e ndryshme nga jeta e përditshme.

Rendi dhe ligji në Komunën e Podujevës

Nga 1 janari 2008 deri 31 dhjetor 2008, në Komunën e Podujevës kanë ndodhur 1763 raste të shkeljes së rendit dhe ligjit, në gjithsejtë 63 shkelje të natyrave të ndryshme. Shkeljet më të mëdha kanë ndodhur në këto fusha:

Tab.9. Numri i rasteve më të shpeshta të shkeljes së rendit dhe ligjit në Podujevë (2008)

Natyra e shkeljes së rendit dhe ligjit	Numri i rasteve të shënuara
Aksidente	385
Prishja e rendit dhe qetësisë publike	84
Pengim i personave zyrtar në kryerjen e punës	25
Vjedhje e pyjeve	29
Incidente lidhur me pronën	84
Vjedhje	512
Abuzime seksuale	7
Shkaktim të dëmtimeve trupore	135
Kërcënime	78
Mashtime	18
Vrasje	15
Incidente në baza etnike, religjioze apo racore	0

Nga tabela e mësipërme mund të shihet se në territorin e kësaj komune gjatë 2008 janë shënuar 385 aksidente, duke e rëndit kështu Podujevën të gjashtë për nga numri i aksidenteve gjatë një viti. Podujeva renditet e katërta edhe për nga numri i madh i vjedhjes së pyjeve, ku vetëm gjatë vitit 2008 pati 29 raste. Në këtë komunë janë shënuar gjithashtu një numër i madh i vjedhjeve, gjithsej 512 raste. Por, më shqetësuese mbetet numri i madh i vrasjeve. Gjatë vitit 2008 kanë ndodhur 15 vrasje.

Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përlogariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifatatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05 % dhe 1 % të vlerës së pronës në treg. Tarifatatimore të tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore. Në bazë të kësaj, Kuvendi Komunal i Podujevës ka miratuar Rregulloren komunale për tatim në pronë sipas së cilës caktohet çmimi i pronës për metër katror në katër zona të ndryshme, dhe norma tatimore e cila sillet nga 0.10% deri 0.20%.

Tab.10. Tatimi në pronë në Komunën e Podujevës

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banesa	Shtëpi			
	Norma tatimore				
	0.10%	0.15%	0.25%	0.20%	0.10%
I	370 €	290 €	700 €	150 €	100 €
II	-	250 €	450 €	150 €	100 €
III	-	200 €	350 €	100 €	100 €
IV	-	100 €	200 €	100 €	100 €

* Vlera e tregut për metër katror.

Kostoja për biznese

Në komunën e Podujevës janë të regjistruara 1,976 biznese private të llojeve të ndryshme. Bizneset janë të regjistruara në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, kurse leja e punës u lëshohet nga administrata komunale e Podujevës. Duke u bazuar në Rregullore komunale për taksa, gjoba dhe ngarkesa, më poshtë kemi pasqyruar disa nga bizneset më të zakonshme dhe shumatat e mjeteve që ato duhet të paguajnë për leje të punës.

Tab.11.. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

Lloji i biznesit	Taksa vjetore e punës
Bankat	1,250 €
Kompanitë e sigurimit	1,250 €
KEK	1,250 €
PTK komunikimi dhe distribucioni	1,250 €
Agjensionet turistike	1,000 €
Hotelet	500 €
Motelet	250 €
Supermarketet-Hipermarketet	250 €
Vetëshërbimet - Minimarketet	250 €
Kafeteritë	250 €
Restorant	250 €
Telekomunikimit	1,250 €
Depot	500 €
Autoshkollat	300 €
Punëtoritë (argjendaritë, zdrukthtaritë, automekanikët, bukëpjekësit, floktarët, etj.)	100 €
Tregtia e jashtme	100 - 150 €
Barnatoret	1000 €
Ndërmarrjet prodhuese	50 €
Veprimtaritë e pavarura profesionale (mjekët, stomatologët, avokaturat, arkitektët, etj.)	500 €

Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shtator-tetor, 2009.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2009. (<http://mef-rks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012 - raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale deri më 30 shtator 2009.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë - të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoba dhe ngarkesa - të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. Debatet komunale 2007 "Jeta në Kosovë", www.jetanekosove.com.
7. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
8. UNDP. Human Development Report - Kosovo 2004.
9. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunat e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2008.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës - janar-dhjetor 2008. Janar, 2009.
11. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës - janar-qershor 2009. Shtator, 2009.
12. MASHT. Statistikat e Arsimit në Kosovë. Prishtinë, 2009.
13. Policia e Kosovës. Statistika në lidhje me raste të ndryshme kriminale dhe aksidente të komunikacionit. 24 gusht 2009.
14. Komisioni Qendror Zgjedhor. Zgjedhjet komunale 2000, 2002 dhe 2007. Si dhe listat e votuesve me të drejtë vote për zgjedhjet e 2009.
15. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndihmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2009.
16. Ministria e Shërbimeve Publike. Të dhënat e të punësuarve në administratë në komuna. Mars, 2008.